

L I G J
Nr. 8934, datë 5.9.2002

PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

(Ndryshuar me ligjin nr. 9537, datë 18.5.2006; nr. 9890, datë 20.3.2008; nr. 9983, datë 8.9.2008; nr. 10137, datë 11.5.2009; nr. 10431, datë 9.6.2011; nr. 91/2013, datë 28.2.2013)

(i ndryshuar)

Në mbështetje të neneve 59 shkronja “d” e pikës 1, 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

KREU I - KREU II
(Shfuqizuar me ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011)

KREU III
PËRDORIMI DHE MBROJTJA E PËRBËRËSVE TË MJEDISIT
(Shfuqizuar nenet 11-19 dhe nenet 25-25/1 me ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011)

Neni 20
Administrimi i mbetjeve

Administrimi i mbetjeve synon parandalimin dhe kufizimin e ndikimeve të tyre të dëmshme në shëndetin e njeriut dhe në mjedis. Administrimi i mbetjeve synon :

1. Parandalimin e krijimit të mbetjeve dhe trajtimin e tyre, duke përdorur teknika e teknologji të përparuara që sigurojnë:

- a) përdorimin e qëndrueshëm të burimeve;
- b) prodhimin e produkteve, që nuk rrezikojnë me mbetje dhe ndotje;
- c) depozitimin përfundimtar të përshtatshëm të lëndëve të rrezikshme, që ndodhen në mbetje, si dhe mundësitë për riciklimin e përpunimin e tyre.

2. Riciklimin, ripërdorimin ose rigjenerimin e mbetjeve në procese të tjera.

Neni 21
Detyrimet e personave fizikë dhe juridikë për mbetjet

Personat fizikë dhe juridikë, veprimtaritë e të cilëve krijojnë ose përpunojnë mbetje, detyrohen të përdorin teknika dhe procese, që nuk paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut, për ujërat, ajrin, tokën, bimët dhe kafshët, që nuk shkaktojnë zhurma, ndotje shtesë ose erë të keqe dhe që nuk dëmtojnë në mënyrë të pakthyeshme natyrën ose qëllimin e veçantë të zonës ku veprojnë.

Neni 22
Importimi i lëndëve dhe mbetjeve të rrezikshme
(Shtuar fjali në pikën 1 dhe pika 4, ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 9890, datë 20.3.2008)

1. Në Republikën e Shqipërisë ndalohet importimi i lëndëve dhe i mbetjeve të rrezikshme,

i mbetjeve dhe mbeturinave të tjera, me qëllim ruajtjeje, depozitimi ose asgjësimi. Importimi i mbetjeve të rrezikshme ndalohet edhe për qëllime përdorimi, përpunimi e riciklimi.

2. Lista e lëndëve dhe e mbetjeve të rrezikshme, e mbetjeve dhe mbeturinave të tjera, për të cilat ndalohet importimi sipas pikës 1 të këtij neni, miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit.

3. Importimi i mbetjeve të ngurta për t'u përdorur, përpunuar e ricikluar bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas rregullave, procedurave, sasive dhe afateve të miratuara prej tij, me propozimin e ministrit.

4. Me propozimin e ministrit, Këshilli i Ministrave miraton listën e mbetjeve, që lejohen të importohen për qëllime përdorimi, përpunimi e riciklimi.

Neni 23

Transportimi tranzit

(Ndryshuar togfjalësh me ligjin nr. 9890, datë 20.3.2008; ndryshuar fjalë me ligjin nr. 10137, datë 11.5.2009)

Transportimi tranzit i mbetjeve dhe i lëndëve të rrezikshme përmes territorit dhe ujërave territoriale e të brendshme të Republikës së Shqipërisë, lejohet vetëm nëse parashikohet në një akt ndërkombëtar, ku Republika e Shqipërisë është palë. Në këto raste, transportimi tranzit bëhet me autorizim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me rregullat e sigurimit të miratuara prej tij dhe të propozuara nga Ministri, në bashkëpunim me ministrat përkatës, sipas llojit të lëndëve dhe mbetjeve të rrezikshme.

Neni 24

Lëndët e rrezikshme

Prodhimi, përdorimi, ruajtja, transportimi i lëndëve të rrezikshme, si dhe administrimi i teknologjive të rrezikshme rregullohen me ligj të veçantë.

KREU IV

VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS

(Shfuqizuar me ligjin nr. 91/2013, datë 28.2.2013)

KREU V

LEJA PËR VEPRIMTARITË QË NDIKOJNË NË MJEDIS

(Shfuqizuar nenet 47- 48 me ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011)

Neni 34

Detyrimi për marrjen e lejes

(Shtuar pika 5 me ligjin nr. 10137, datë 11.5.2009)

1. Personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, janë të detyruar të marrin miratimin nga organet përgjegjëse, të caktuara në këtë ligj për zhvillimin e veprimtarive, që ndikojnë ose mund të ndikojnë në mjedis.

2. Personi fizik ose juridik paraqet kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për të marrë miratimin.

3. Miratimi i kërkesës bëhet me paraqitjen e deklaratës mjedisore, të lejes mjedisore, me pëlqimin ose autorizimin, sipas rasteve të specifikuara në këtë ligj.

4. Deklarata mjedisore, leja mjedisore, pëlqimi dhe autorizimi, janë dokumente zyrtare, që përcaktojnë kushtet dhe rrethanat në të cilat do të zhvillohet veprimtaria e miratuar, për parandalimin dhe pakësimin e ndikimeve të saj në mjedis.

5. Deklarata mjedisore, leja mjedisore, leja e integruar mjedisore, autorizimi mjedisor dhe pëlqimi mjedisor, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë III.1, të shtojcës së ligjit për licencat. Miratimi i tyre bëhet sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave në vijim të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos përdorimin e njërës nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në nënkategori.

Neni 35

Deklarata mjedisore

(Ndryshuar togfjalësh në pikën 1 me ligjin nr. 9890, datë 20.3.2008)

1. Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe këshillimit me palët e interesuara për projektet, strategjitë, planet e zhvillimit, Ministri shpall qëndrimin zyrtar me deklaratën mjedisore.

2. Deklarata mjedisore përmban arsyetimin teknik dhe mbështetjen ligjore, jep argumentet përkatëse dhe masat që duhen marrë për të shmangur dhe pakësuar ndikime më të mëdha në mjedis.

3. Kur deklaratata mjedisore është negative, projekti, strategjia ose plani i zhvillimit nuk miratohen nga organet përkatëse vendimmarrëse. Kur deklaratata mjedisore është pozitive, miratimi nga këto organe bëhet në përputhje me përmbajtjen dhe kushtet e deklaratës.

4. Nëse projekti nuk fillon të zbatohet brenda dy vjetëve nga data e miratimit, deklaratata mjedisore bëhet e pavlefshme dhe procedura e aplikimit fillon nga e para.

5. Nëse zbatimi i projektit kryhet në përputhje me deklaratën mjedisore dhe lejen e ndërtimit, organi përgjegjës e pajis me lejen mjedisore përkatëse, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

Deklarata mjedisore bëhet publike.

Neni 36

Leja mjedisore

(Ndryshuar togfjalësh në pikën 1 dhe 2, shtuar pikat 3 dhe 4 me ligjin nr. 9890, datë 20.3.2008; ndryshuar togfjalësh në pikën 3 me ligjin nr. 10137, datë 11.5.2009)

1. Shfrytëzimi i pasurive minerare e i burimeve natyrore, vënia në punë e instalimeve për shfrytëzimin dhe përpunimin teknologjik të tyre dhe veprimtaritë e tjera që ndikojnë në mjedis, për të cilat kërkohet leje mjedisore, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit.

2. Me leje mjedisore pajisen edhe zgjerimet dhe rikonstruksionet, nëse këto përfaqësojnë ndryshime themelore të kushteve gjatë veprimtarive, si dhe mbyllja dhe çmontimi i veprimtarive e instalimeve. Ministri propozon veprimtari të reja, që duhet të pajisen me leje mjedisore.

3. Leja mjedisore jepet, hiqet, rishikohet e ndryshohet vetëm sipas dispozitave të këtij ligji.

4. Nëse veprimtaria e pajisur me leje mjedisore nuk fillon brenda dy vjetëve nga data e miratimit të saj, leja bëhet e pavlefshme dhe procedura e aplikimit fillon nga e para.

Neni 36/1

Leja e integruar mjedisore

(Shtuar me ligjin nr. 9890, datë 20.3.2008)

Leja e integruar mjedisore lëshohet në rast se veprimtaria e propozuar:

a) është e një natyre të tillë, për të cilën kërkohet një leje mjedisore, e mbështetur në legjisllacion më të zgjeruar sesa në një ligj të veçantë;

b) i nënshtrohet parandalimit dhe kontrollit të integruar të ndotjes, sipas nenit 17 të këtij ligji.

Neni 37

Dokumentacioni për leje mjedisore

1. Dokumentacioni për të kërkuar leje mjedisore dhe elementet që përmban leja mjedisore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Përcaktimi i kushteve dhe i kërkesave që vendosen në lejen mjedisore, mbështetet në normat e shkarkimeve, në normat e cilësisë dhe në teknikat më të mira të mundshme, që sigurojnë sasi më të vogla të shkarkimeve në mjedis, përdorime të frytshme të burimeve dhe të energjisë dhe mbrojtje më të mirë të mjedisit.

Neni 38

Afatet e shqyrtimit të kërkesave për miratim mjedisor

(Ndryshuar pikat 1 dhe 2 me ligjin nr. 9890, datë 20.3.2008; ndryshuar me ligjin nr. 9983, datë 8.9.2008)

1. Deklarata mjedisore, leja mjedisore, autorizimi mjedisor dhe pëlqimi mjedisor shqyrtohen dhe miratohen brenda afateve të mëposhtme:

- a) deklarata mjedisore, brenda 3 javëve nga paraqitja e kërkesës;
- b) leja mjedisore, brenda 5 javëve nga paraqitja e kërkesës;
- c) autorizimi dhe pëlqimi mjedisor, brenda 2 javëve nga paraqitja e kërkesës.

2. Koha për plotësimin e dokumentacionit, sipas kërkesave të nenit 37 të ligjit në fuqi, nuk llogaritet në afatet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” e “c” të pikës 1 të këtij neni.

3. Nëse kërkuuesi nuk i përgjigjet, brenda tre muajve, kërkesës me shkrim të organit miratues, për plotësim apo përmirësim dokumentesh, vlerësohet se është hequr dorë nga kërkesa për miratim mjedisor.

4. Kur është e nevojshme kryerja e ekspertizave të kualifikuara, organi përgjegjës, me vendim të arsyetuar, mund ta zgjasë kohën e dhënies së secilit dokument, deri në dyfishin e kohës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

5. Nëse organi miratues nuk përgjigjet brenda afateve të mësipërme, secili dokument quhet i miratuar dhe kërkuuesi mund ta vazhdojë veprimtarinë. Ndërkohë organi miratues njofton kërkuuesin për kushtet dhe kërkesat e dokumentit të miratimit.

6. Secili dokument i përmendur në pikën 1 të këtij neni është i vlefshëm nga çasti i fillimit të veprimtarisë dhe për sa kohë që kushtet, në bazë të të cilave është miratuar dokumenti, nuk ndryshojnë.

Neni 39

Palët në proces

(Ndryshuar togfjalësh në pikën 2 me ligjin nr. 9890, datë 20.3.2008; ndryshuar pika 4 me ligjin nr. 10137, datë 11.5.2009)

1. Procesi i shqyrtimit të kërkesës për dhënien e deklaratës dhe të lejes mjedisore është i hapur për të gjitha palët e interesuara, duke përfshirë edhe shtete, në rast ndikimi ndërkufitar në mjedis.

2. Ministria njofton dhe siguron mundësi të barabarta, gjatë një muaji, për të gjitha palët e interesuara të procedurës së aplikimit, që të njihen me dokumentacionin, deklaratën dhe lejen mjedisore.

3. Vendimi për miratimin ose jo të kërkesës bëhet publik.

4. Personat fizikë dhe juridikë, publiku dhe organizatat jofitimprurëse mjedisore mund të ankohen në gjykatën kompetente, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 39/1

Përmbajtja e lejes mjedisore

(Shtuar me ligjin nr. 9890, datë 20.3.2008)

Çdo leje mjedisore përmban:

- a) një përshkrim të veprimtarisë së lejuar, përfshirë emërtimin, natyrën, vendndodhjen e saj, si dhe hollësitë e çdo shkarkimi të autorizuar nga leja;
- b) të dhëna të mbajtësit të lejes;
- c) kërkesat dhe kushtet e ndërtimit dhe të funksionimit të veprimtarisë së lejuar;
- ç) kërkesat e raportimit, që përfshijnë edhe normat e standardet mjedisore të shkarkimeve;
- d) çdo kusht apo informacion tjetër, sipas këtij ligji, ligjeve të tjera të veçanta mjedisore dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre.

Neni 39/2

Formati i lejes

(Shtuar me ligjin nr. 9890, datë 20.3.2008)

Lejet mjedisore formatohen në përputhje me llojin e veprimtarive. Formatimi i tyre miratohet nga ministri.

Neni 40

Përtëritja e lejes mjedisore

(Shfuqizuar me ligjin nr. 9890, datë 20.3.2008)

Neni 41

Ndryshimi i lejes mjedisore

(Shfuqizuar pika 2 me ligjin nr. 9890, datë 20.3.2008)

1. Organet që japin lejen mjedisore e rishohin, e ndryshojnë ose e heqin atë në çdo kohë nëse:

- a) shfaqen elemente të reja ekologjike të panjohura në kohën e dhënies së saj;
 - b) dalin dispozita të reja për mjedisin, që e kërkojnë shprehimisht ndryshimin e saj;
 - c) vërtetohet ndotje tej normave të lejuara;
 - ç) ka ndryshime themelore të veprimtarisë;
 - d) ka përparime në fushën e teknikave më të mira të mundshme, që lejojnë pakësimin e rëndësishëm të shkarkimeve në mjedis dhe që nuk kërkojnë shpenzime të mëdha;
 - dh) ndryshohet kërkesa e sigurimit teknik, duke përdorur teknika të tjera më të mira.
2. Shfuqizuar.

Neni 42

Transferimi i lejes

(Ndryshuar me ligjin nr. 9890, datë 20.3.2008)

1. Leja mjedisore është personale dhe mund të transferohet te një person tjetër fizik ose juridik, kur veprimtaria e pajisur me leje kalon në pronësi apo në përdorim të tij. Transferimi bëhet vetëm me miratimin me shkrim të organit që ka lëshuar lejen, në bazë të kërkesës së të interesuarit, shoqëruar me dokumentet që provojnë kalimin e pronësisë apo të përdorimit.

2. Ndryshimi i administratorit të një personi juridik nuk është shkak për transferimin e lejes mjedisore.

Neni 43

Tarifa e shërbimit

(Ndryshuar togfjalësh në pikën 1 dhe 2 me ligjin nr. 9890, datë 20.3.2008)

1. Personat fizikë e juridikë që pajisen me leje mjedisore, paguajnë një tarifë shërbimi, që caktohet nga Ministri. Tarifa derdhet në llogarinë e organit që ka dhënë lejen.

2. Projektet dhe nismat, që kryhen për mbrojtjen e mjedisit ose që jepen si ndihmë për Shqipërinë, përjashtohen nga tarifa e shërbimit për dhënien e lejes mjedisore dhe u krijohen lehtësi fiskale. Këto veprimtari dhe kriteret e përfitimeve të tyre përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit dhe Ministrit të Financave.

Neni 44

Detyrimi i lejes mjedisore

1. Veprimtaritë dhe instalimet që ndikojnë në mjedis nuk mund të fillojnë të ushtrohen ose të vihen në punë pa marrë lejen mjedisore.

2. Personat fizikë dhe juridikë nuk mund ta ushtrojnë veprimtarinë veçse në përputhje me kushtet dhe kërkesat e vendosura në lejet mjedisore.

3. Veprimtaritë që ndikojnë në mjedis, kur ushtrohen pa leje mjedisore, sipas rastit, pezullohen, mbyllen ose ndërpriten plotësisht ose pjesërisht nga Inspektorati i Mjedisit.

Neni 45

Pëlqimi dhe autorizimi

(Ndryshuar togfjalësh në pikën 2 me ligjin nr. 9890, datë 20.3.2008)

1. Veprimtaritë me karakter vendor, që ndikojnë në mjedis, por që nuk përfshihen në vendimin e Këshillit të Ministrave, të përmendura në pikën 1 të nenit 36 të këtij ligji, miratohen nga agjencitë rajonale të mjedisit, në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore. Miratimi për këto veprimtari jepet në formën e pëlqimit ose të autorizimit.

2. Ministri miraton sipas këtij neni listën e veprimtarive, formatin e aplikimit dhe rregullat e procedurat e dhënies së pëlqimit ose të autorizimit nga agjencitë rajonale të mjedisit.

Neni 45/1

Regjistri i lejeve mjedisore

(Shtuar me ligjin nr. 9890, datë 20.3.2008)

1. Ministria dhe çdo agjenci rajonale mbajnë regjistrin e lejeve mjedisore, formati i të cilit miratohet nga ministri. Në regjistër shënohen të dhëna:

a) për kërkesat për dhënien e çdo lejeje të re mjedisore, si dhe për ndryshimin apo modifikimin e lejeve të miratuara;

b) për të gjitha lejet mjedisore të miratuara;

c) të cilat mbajtësi i lejes ia përcjell agjencisë rajonale të mjedisit, në përputhje me kërkesat e lejes;

ç) për çdo masë të vendosur nga Inspektorati i Mjedisit ndaj veprimtarisë së pajisur me leje.

2. Në një regjistër, që mbahet sipas këtij neni, nuk mund të përfshihet asnjë informacion, që vë në rrezik sigurinë kombëtare apo që e cenon atë.

3. Regjistrat e krijuar dhe të administruar, në përputhje me këtë nen, janë të hapur për konsultim pa pagesë nga publiku, gjatë orarit të zakonshëm të punës dhe administruesi i tij siguron lehtësi për t'i mundësuar publikut të marrë kopje të të dhënave të regjistrit me tarifa të arsyeshme, të miratuara nga ministri.

4. Kërkuesi ose mbajtësi i lejes mund t'i kërkojë ministrisë, që informacioni për lejen mjedisore ose kërkesën për leje të mos shënohet në regjistër ose të mos i jepet publikut kur:

- a) përbën sekret tregtar;
- b) dhënia e tij do t'i shkaktonte atij dëm ose humbje ekonomike.

5. Për të përjashtuar ose jo një informacion nga një regjistër apo për të mos ia dhënë publikut, sipas pikës 4 të këtij neni, administruesi i tij i kërkon operatorit paraqitjen e dokumenteve dhe të fakteve, që provojnë vërtetësinë e dëmit ose të humbjes ekonomike që ai pretendon.

6. Për të përcaktuar nëse një informacion duhet përjashtuar apo jo nga një regjistër, administruesi i tij balancon interesin publik për nxitjen e aksesit ndaj informacionit mjedisor me interesat konkretë të aplikantit.

Neni 46

Detyrime të përgjithshme

(ndryshuar shkronja "e" e pikës 1 dhe togfjalësh në pikën 3 me ligjin nr. 9890, datë 20.3.2008)

1. Gjatë vënies në punë të veprimtarive dhe instalimeve, personat fizikë e juridikë sigurojnë:

- a) zbatimin e të gjitha masave që parandalojnë shkarkimet mbi normë dhe ndotjen e mjedisit;
- b) shmangien dhe pakësimin e mbetjeve dhe, aty ku përdorimi i tyre nuk është i mundur teknikisht ose ekonomikisht, neutralizimin e tyre, duke shmangur dhe pakësuar ndikimin në mjedis;
- c) parandalimin e aksidenteve industriale dhe kufizimin e pasojave të tyre;
- ç) kthimin e vendit në kushte të kënaqshme mjedisore pas përfundimit të veprimtarisë;
- d) njoftimin për çdo ndryshim të planifikuar të linjës teknologjike;
- dh) respektimin e kërkesave dhe të kushteve të lejes mjedisore;
- e) njoftimin e agjencive rajonale të mjedisit për rezultatet e vetëmonitorimit dhe, në çdo kohë, për aksidentet ose emergjencat me ndikim negativ në mjedis. Afatet e njoftimit të rezultateve të vetëmonitorimit përcaktohen me urdhër të ministrit, në bazë të llojeve të veprimtarive.
- ë) plotësimin e kërkesave të Inspektoratit të Mjedisit gjatë kryerjes së kontrollit të veprimtarisë së tyre;
- f) njohjen e publikut me gjendjen e mjedisit dhe profilin mjedisor të veprimtarisë së tyre;
- g) mbajtjen e regjistrave për shkarkimet në mjedis, për përdorimin e ujit dhe të energjisë, si dhe për teknikat e përdorura.

2. Kërkesat e këtij neni zbatohen si më poshtë:

- a) për veprimtaritë dhe instalimet e reja, 1 vit pas hyrjes në fuqi të ligjit;
- b) për veprimtaritë ekzistuese, jo më shpejt se 2 vjet dhe jo më vonë se 5 vjet pas hyrjes në fuqi të ligjit.

3. Ministria, në bashkëpunim me ministritë e linjës, ndërmerr fushata ndërgjegjësimi për njohjen me kërkesat e këtij ligji.

KREU VI

PARANDALIMI DHE KUFIZIMI I NDOTJES SË MJEDISIT

(Shfuqizuar nenet 50-51 me ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011)

Neni 49

Parandalimi i aksidenteve industriale

(Ndryshuar togfjalësh në pikën 2 me ligjin nr. 9890, datë 20.3.2008)

1. Personat fizikë dhe juridikë, që në veprimtaritë e tyre përdorin lëndë të rrezikshme, detyrohen të ngrenë sistemin e parandalimit dhe të kontrollit të aksidenteve, për të shmangur pasojat për jetën, shëndetin e njeriut dhe për mjedisin.

2. Identifikimi i veprimtarive gjatë të cilave përdoren lëndë të rrezikshme, kriteret e ngritjes së sistemeve të parandalimit dhe të kontrollit të aksidenteve, masat që duhen marrë, detyrimet e personave fizikë e juridikë, organet kontrolluese dhe përgjegjësitë e tyre, rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e përbashkët të Ministrit, Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministrit të Shëndetësisë dhe Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit.

Neni 51/1

Parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes

(Shtuar me ligjin nr. 9890, datë 20.3.2008)

1. Me propozimin e ministrit, Këshilli i Ministrave miraton listën e veprimtarive, të cilat, për shkak të tendencës së tyre për të shkaktuar dëm mjedisor, do t'i nënshtrohen parandalimit dhe kontrollit të integruar të ndotjes dhe do të pajisen me leje mjedisore të integruar (këtu e tutje referuar si leje IPPC), në përputhje me dispozitat e këtij neni.

2. Kërkesat, dokumentet dhe informacionet që e shoqërojnë, rregullat dhe procedurat për lejet e integruara, si dhe për parandalimin e kontrollin e integruar të ndotjes, sipas direktivës IPPC të KE-së, miratohen me udhëzim të ministrit.

3. Në përcaktimin e një kërkesë për një leje IPPC, ministri mban parasysh këto parime:

a) marrjen e masave të përshtatshme kundër ndotjes, nëpërmjet zbatimit të teknikave më të mira në dispozicion;

b) veprimtaria të mos shkaktojë asnjë ndotje të konsiderueshme;

c) shmangien e gjenerimit të mbetjeve dhe, kur kjo nuk është e mundur, riciklimin e tyre, ose kur kjo është e pamundur nga pikëpamja teknike ose ekonomike, asgjësimin për të shmangur ose ulur ndikimin në mjedis;

ç) përdorimin me efektivitet të energjisë;

d) marrjen e masave të përshtatshme, për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre;

dh) marrjen masave të nevojshme për ndërprerjen përfundimtare të veprimtarisë, për të shmangur çdo rrezik ndotjeje dhe për ta kthyer vendin e veprimtarive në gjendje të përshtatshme.

4. Për të arritur një nivel shumë të lartë të mbrojtjes së mjedisit në çdo leje IPPC do të parashtrihen këto kushte:

a) përcaktimin e masave për mbrojtjen e ajrit, ujit dhe tokës;

b) përdorimin e teknikave më të mira në dispozicion;

c) vendosjen e standardeve të detyrueshme mjedisore mbi shkarkimet ose, sipas rastit, të parametrave të barasvlefshme ose të masave teknike;

ç) parashikimin e mbrojtjes së tokës dhe të ujërave tokësore dhe të masave për menaxhimin e mbetjeve;

d) parandalimin ose minimizimin e ndotjes në distancë të largët ose ndotjes ndërkufitare;

dh) specifikimin e pajisjeve dhe të procedurave monitoruese, përveç kërkesave të raportimit;

e) informimin nga mbajtësi i lejes të ministrisë për çdo incident ose aksident, që cenon mjedisin në shkallë të konsiderueshme.

KRERËT VII - XI

(Shfuqizuar me ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011)

Neni 89
Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligjet nr. 7664, datë 21.1.1993 “Për mbrojtjen e mjedisit”, nr.8364, datë 2.7.1998 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7664, datë 21.1.1993 “Për mbrojtjen e mjedisit””, nr.8825, datë 5.11.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7664, datë 21.1.1993 “Për mbrojtjen e mjedisit”, si dhe çdo akt tjetër normativ, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 90

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3490, datë 9.10.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**